



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21,22 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt.25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05 Nr.350/03-188067/21 dt. 07.09.2021, për rishqyrtim të kërkesës 05 Nr.350/02-83023/21 dt. 10.08.2021, të aplikuesit Bekim Fejzullahu nga Prishtina, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor - projektin ideor për ndërtimin e ndërtesës, shtëpi individuale banimore, në lagjen Taslixhe, Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 16.11.2021, merr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I Caktohen kushtet ndërtimore bashkëpronarit Bekim Fejzullahu nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr.350/03-188067/21 dt. 07.09.2021, për rishqyrtim të kërkesës 05 Nr.350/02-83023/21 dt. 10.08.2021, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor - projektin ideor, për ndërtimin e ndërtesës, shtëpi individuale banimore, me etazhitet S+P+1, në lagjen Taslixhe, me adresë rr. “Ismet Jashari”, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban - PZHU, gjegjësisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 2317-8, ZK Prishtinë.

II. Lokacioni i parcelës kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të Planit Zhvillimor Urban - PZHU, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 035-181427 dt. 24.09.2013, dhe kjo zonë sipas Informim nga Plani Zhvillimor Urban, është e planifikuar me destinim banimi - “ndërtim individual”;

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcela kadastrale e trajtuar, sipas gjendjes faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
 - nr. 2317-8, me S=429 m², me pronar Bekim Fejzullahu, “Tokë ndërtimore” – S=363 m² dhe “Shtëpi-ndërtesë” – S=66 m²;
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe çertifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelës kadastrale të lartcekur ka ndërtesa të ndërtuara, në rrethinë ka ndërtesa individuale banimi;
- Terreni ka pjerrtësi në drejtime veri-jug me disnivel rreth 4 m;
- Parcela ka qasja në rrugë lokale ekzistuese;

IV. Kushtet ndërtimore për rregullimin dhe realizimin e dokumentacionit ndërtimor - projektin ideor, të objektit janë:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës kadastrale, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në dispozitën urbanistike, e cila i është bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e Kushteve ndërtimore;

- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të parcelës kadastrale planifikohet ndërtimi i shtëpisë individuale të banimit, me sipërfaqe ndërtimore, shtrirje, etazhitet dhe kriteret e tjera normative-ligjore, sipas llogarive dhe projekt propozimit, si në vijim:

Shtëpi individuale banimore

$S=335.70 \text{ m}^2$ / me sipërfaqe mbitokësore $S=275.03 \text{ m}^2$ dhe sipërfaqe nëntokësore 60.67 m^2 :

- Etazhiteti i lejuar për objekte sipas PZHU-së duhet të jetë I-III / Sipas projekt propozimit S+P+1;
- Parcela kadastrale nr. 2317-8, ZK Prishtinë, ka sipërfaqe totale prej $S=429 \text{ m}^2$, prej së cilës sipërfaqja prej $S=363 \text{ m}^2$ është "Tokë ndërtimore" dhe sipërfaqja prej $S=66 \text{ m}^2$ është "Shtëpi-ndërtese", andaj sipërfaqja e llojit të shfrytëzimit - tokë ndërtimore do të trajtohet me këto kushte ndërtimore, edhe për faktin që një pjesë e saj është me destinim gjelbrimi sipas PZHU-së;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore - brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e shputës së ndërtesës, sipas PZHU-së, është max.30%:
 $S=405 \times 0.3=121.50 \text{ m}^2$ / sipas PZHU-së,
 $S=121.35 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit;
- Bazuar në kriteret e PZHU-së, koeficienti ndërtimor është i përcaktuar, dhe ajo sipërfaqe ndërtimore do të llogaritet si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , **50%** për etazhet me vëllim mbi **51%** mbi tokë- suterren dhe **0%** për etazhet e nëntokës-bodrome;
- Koeficienti minimal i shfrytëzimit të parcelës me gjelbërim (ISHPGJ) është min. 40%, bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, 01 nr.031-185481 dt. 14.08.2015 dhe ajo duhet të jetë:
 $S=405 \times 0.4=162.00 \text{ m}^2$ / sipas PZHU-së,
 $S=183.60 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit;
- Indeksi i sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore të parcelës (ISPN) të jetë 0.6-0.8;
 $S=405 \times 0.6=243.00 \text{ m}^2$ / minimale sipas PZHU-së,
 $S=405 \times 0.8=324.00 \text{ m}^2$ / maksimale sipas PZHU-së,
 $S=275.03 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt. 14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Indeksi i shfrytëzimit të nëntokës (ISHN), sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, mund të jetë 60%;
 $S=405 \times 0.6=243.00 \text{ m}^2$ / maksimale sipas Vendimit të Kryetarit,
 $S=60.67 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit;
- Qasja në objekt duhet të jetë nga rruga ekzistuese;
- Distanca minimale e objektit nga bordura e rrugës, duhet të jetë:
 - jo më pak se 5 m për rrugë me gjerësi deri në 7 m,
 - jo më pak se 7.5 m për rrugë me gjerësi deri 7 -15 m,
- Distanca e objektit nga kufiri me parcelat fqinje duhet të jetë 0.50-0.75 H;
- Arkitektura - dukja e jashtme (fasadat) e ndërtesës dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore, me masa të efijencës së energjisë, të qëndrueshme dhe duhet t'i përshtatet ndërtesave të rrethinës;
- Për shtëpi individuale banimi duhet të sigurohet 1 vendparkim, për njësi;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve nuk duhet të dal jashtë parcelës ndërtimore.
- Të bëhet aplikimi i të gjitha kriterëve, normave dhe standardeve urbane, të planifikimit dhe arkitektonike të përcaktuara nga PZHU.

V. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit, numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të ndërtesës (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"- Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VI. Dokumentacioni ndërtimor - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Inçizimin gjeodezik;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhësë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, 3D - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës, kanalizim dhe rrjetin e energjisë elektrike;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore - zeytare, me paramasë dhe parallogari;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe të mbrojtjes nga zhurma, me analiza konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme

VII. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtorja e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);

- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkesit/ve (bashkëpronarëve të parcelës dhe investitorit);

VIII. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin ideor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

IX. Leje rrënim - Në procedurë të kërkesës për leje ndërtimore ose paraprakisht, duhet të parashtrohet edhe kërkesa për rrënimin e ndërtesës ekzistuese, shtëpisë banimore, me etazhitet S+P+1, e cila gjendet në kuadër të parcelës kadastrale nr. 2317-8, ZK Prishtinë;

X. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Investitori/pronari Bekim Fejzullahu nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr.350/03-188067/21 dt. 07.09.2021, për rishqyrtimin e kërkesës 05 Nr. 350/02-83023/21, dt. 12.05.2021 ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor - projektit ideor, për ndërtimin e ndërtesës, shtëpi individuale banimore, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Me kërkesë, pronari ka prezantuar dokumentacionin, si në vijim:

- *Dëshminë mbi pronësinë, Certifikatë dhe Kopja e planit, për parcelë kadastrale nr. 2317-8, ZK Prishtinë;*
- *Inçizimin gjeodezik “Situacioni i terrenit” të njësisë nr. 2317-8, ZK Prishtinë, punuar nga kompania gjeodezike “Geo-Group” sh.p.k., me licencë nr.47;*
- *Projektin konceptual arkitektonik, të hartuar nga “Arch IN O.P.” sh.p.k., me numër të regjistrimit të biznesit 810906092, me adresë “Shefqet Shkupi”, nr.20, Prishtinë, me projektes përgjegjës Isa Nasufi i.d.a.;*
- *Shkresën “Informim nga Plani Zhvillimor Urban - PZHU” me referencë 04-350/01-45833/21 dt. 10.03.2021 të datës 16.03.2021, të lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm – Prishtinë”;*
- *Shkresën “Aktvendim” nr. 01-201/1645 dt.11.02.2009, të lëshuar nga Drejtorati i Administratës së Përgjithshme – sektori i regjistrimit civil, në të cilin mbiemri i Bashkim Gashi nga Prishtina është ndërruar në Bashkim Kotorri, së bashku me kopjen e letërnjoftimit;*
- *Shkresën “Kontratë” nr. 1482 dt. 04.10.1975 të lëshuar nga Drejtoria për ndërtimin dhe rekonstruktimin e Prishtinës, për ndërtim në parcelën nr. 2317-8, kopje e vërtetuar me numër protokollit 03/225 dt. 15.06.2021 të lëshuar nga Arkivi Komunal Prishtinë;*
- *Shkresën “Aktvendim” të lëshuar nga Sekretariati për punë komunale, të banesave dhe i punëve të urbanizmit të KK Prishtinë, me të cilin i lejohet ndërtimi i aneksit të ndërtesës në parcelën kadastrale nr. 2317-8, kopja e vërtetuar me numër protokollit 03/225 dt. 15.06.2021 të lëshuar nga Arkivi Komunal Prishtinë;*
- *Akti noterial “Deklaratë” LRP-nr.Rend. 14193/2021 të datës 04.09.2021, të lidhur te notere Vizhdane Kuçi, me të cilin Bashkim Kotorri pronar i njësisë kadastrale nr. 2317-9, i jep pëlqim pronarit të njësisë kadastrale nr. 2317-8, Bekim Fejzullahu të ndërtoi në pronën e tij në çfarëdo distance nga kufiri i parcelës së tij;*
- *Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve tatimore, në emër të Bekim Fejzullahu, me nr. 82992/21 (21949424) dt. 12.05.2021;*

- Fotokopjen e dokumentit të identifikimit të pronarit;
- Fotot e lokacionit.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, ka pranuar kërkesën 05 Nr.350/03-188067/21 dt. 07.09.2021, për rishqyrtimin e kërkesës 05 Nr.350/02-83023/21 dt. 12.05.2021, të pronarit Bekim Fejzullahu nga Prishtina, me anë të të cilës është kërkuar caktimi i kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor - projektin ideor, për ndërtimin e ndërtesës, shtëpi individuale banimore, me etazhitet S+P+1, e cila shtrihet në kuadër të Planit Zhvillimor Urban – PZHU, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 2317-8, ZK Prishtinë.

Paraprakisht aplikuesi i është drejtuar Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, me kërkesën 05 Nr.350/02-83023/21 dt. 12.05.2021, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor - projektit ideor, e cila kishte konstatuar se kërkesa nuk është e plotë, andaj, për vazhdimin e procedurave administrative për shqyrtimin e kërkesës, ka lëshuar shkresën "Plotësim dokumentacioni" me 05 Nr.350/02-83023/21 dt. 12.05.2021, të datës 18.06.2021, me anë të të cilës është kërkuar plotësim/ndryshimi i lëndës me dokumentacionin si në vijim: *"Të prezantohet projekti konceptual i ndërtesës, duke respektuar kriteret e planit, si distanca, sipërfaqja ndërtuese, sipërfaqja gjelbëruese dhe të gjitha kriteret tjera sipas dokumentit të planifikimit hapësinor, Planit Zhvillimor Urban – PZHU-së. Për distancë nga parcela fqinje të respektohet kriteri minimal 0.5-0.75 H ose të prezantohet pëlqim për afërsi më të vogël se distanca minimale; Sipërfaqja gjelbëruese të jetë 40 %, siç parashihet me Vendim të Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01 Nr.031-185481 dt. 14.08.2015."*

Aplikuesi me "Plotësim lënde" 05 Nr.350/02-83023/21/1 dt. 23.06.2021, ka prezantuar dokumentacionin e kërkuar pjesërisht, andaj, meqë pala nuk ka plotësuar kërkesën si të plotë brenda afatit ligjor për plotësimin e dokumentacionit, sipas nenit 21, pika 4 të Ligjit 04/L-110 për ndërtim dt. 31.05.2012, kjo kërkesë si e tillë është refuzuar me aktin administrativ "Vendim për refuzimin e kërkesës" 05 Nr.350/02-83023/21 dt. 10.08.2021.

Pas pranimit të aktit administrativ "Vendim për refuzimin e kërkesës" 05 Nr.350/02-83023/21 dt. 10.08.2021, dhe pas kompletimit të kërkesës me dokumentacionin e kërkuar, harmonizimit me legjislacionin në fuqi, gjegjësisht dokumentin e planifikimit hapësinor - kriteret e planit, aplikuesi, me kërkesën 05 Nr.350/03-188067/21 dt. 07.09.2021, ka kërkuar rishqyrtimin e kërkesës 05 Nr.350/02-83023/21 dt. 12.05.2021, për caktimin e kushteve ndërtimore, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor - projektin ideor, për ndërtimin e shtëpisë individuale banimore, me etazhitet S+P+1, e cila shtrihet në kuadër të Planit Zhvillimor Urban – PZHU, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 2317-8, ZK Prishtinë.

Pas kontrollimit të projektit konceptual nga përgjegjësi për komunikacion i kësaj drejtorie, i njëjti ka konstatuar si në vijim: *"Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Bekim Fejzullahu në lagjen Taslixhe të Prishtinës, lidhur me kërkesën e kushteve ndërtimore të lëndës 05-350/02-83023/21 dt. 12.05.2021, kyçja për automjete në rrugën ekzistuese "Ismet Jashari" për ndërtesën banimore - shtëpi individuale me etazhitet S+P+1, të paraparë me këtë zgjidhje urbane, mund të pranohet si e tillë. Kyçja duhet ti përshtatet teknikisht rrugës ekzistuese dhe të aplikohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes edhe në kohën kur realizohet ajo."*

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkëngjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni, Planit Zhvillimor Urban - PZHU, rregullativës ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, projektit konceptual, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L- 110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenit 12 dhe 13 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e

kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve, si dhe pas përfundimit të procedurës së vendosjes së njoftimit publik, i cili ka qëndruar në lokacion për 5- pesë ditë (25.10.2021 - 29.10.2021), meqë gjatë kësaj kohe nuk është pranur ndonjë koment apo sugjerim, ka konstatuar se, kërkuuesi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projekti konceptual i prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të dokumentit të planifikimit hapësinor për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Situacioni i ngushtë.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

Ky vendim u printua në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuuesit, kësaj drejtorie, në dosje të lëndës 05 Nr.350/03-188067/21 dt. 07.09.2021 dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 Nr. 350/03-188067/21 DT. 16.11.2021**

Zyrtar:
Liridon Gashi



U.D. Udhëheqëse e Sektorit:
Mimoza Berisha Prestreshi



